

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE
"P.A.M.A GROUP" SH.P.K

Sot me date 27.10.2020

- *MARIO PANELLA, atesia (GIOVANNI), shtetas italian, lindur me 190911964, ne (ROMA) , Itali dhe banues ne ROME , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AV0039582*

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDREN KOMBETARE TE BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI I

1. Sot ne date 27.10.2020, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

" P.A.M.A GROUP " SH.P.K .

2. Themeluesit e shoqerise jane:

- *MARIO PANELLA, atesia (GIOVANNI), shtetas italian, lindur me 190911964, ne (ROMA) , Itali dhe banues ne ROME , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AV 0039582*



NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Rcalizimi i punimeve të ndërtimit në përgjithësi, përpunimi dhe ndërtimi i punimeve të rrugës së skelave të ndërtesave duke përfshirë gërmimet, shkatërrimet, ndërtimin e rezervave të ujit, kanalizimeve dhe të ngjashme.
2. Blerja dhe shitja, shkëmbimi, projektimi, ndërtimi, prishja, mirëmbajtja dhe menaxhimi me koncesion, rizhvillimi, dhënia me qira e tokës, ndërtesave dhe pasurive të patundshme të të gjitha llojeve, ndërtesave dhe punëve civile, ndërtesave në përgjithësi, impianteve të prodhimit, hoteleve dhe akomodimi dhe objektet tregtare, impiantet industriale dhe / ose komplekset industriale, termocentralet dhe impiantet teknologjike në përgjithësi,
3. Ndërtimi i ndërtesave të ndryshme industriale, socio-kulturore, civile dhe jo civile, ndërtimi i infrastrukturës, ndërtimi i apartamenteve të banimit dhe vilave, kanalizimi dhe furnizimi me ujë, rrugët, materialet e ndërtimit, rehabilitimi i ndërtesave dhe rindërtimi i ndërtesave eksporti civil dhe jo civil të makinave të ndërtimit dhe të gjitha produkteve që lidhen me aktivitetin e ndërtimit.
4. Projektimi, studimi, mbikëqyrja e punëve të ndryshme civile dhe jo-civile të ndërtimit.
5. Prodhimi, përpunimi, nxjerrja e materialeve inerte dhe betonit, transporti dhe tregtia e tyre brenda dhe jashtë vendit të tyre, eksportet e tyre të importit dhe të gjitha makineritë e përdorura për nxjerrjen inerte dhe aktivitetet e përpunimit.
6. Gërmimi dhe transportimi i materialeve të ndërtimit, Prodhimi dhe furnizimi me beton
7. Shitje me pakicë dhe shumicë e materialeve hidraulike dhe termike, projektimi, instalimi, mirëmbajtja dhe riparimi i sistemeve të kondicionimit të ajrit, sistemeve të gazit termik dhe termik, sistemeve elektrike, si dhe tregtia, importi dhe eksportet përkatëse
8. Shitje me pakicë dhe shumicë e pajisjeve për instalimin, montimin dhe riparimin e instalimeve të përshkruara më sipër
9. Ndërtimi i gazsjellësve dhe tubacioneve të ndryshme, përfshirë ndërtimin e veprave të artit, gërmimet dhe ndërtimin e rrugëve.
10. Ekzekutimi i punëve për të cilat ndërmarrja do të jetë e vetmja ose kontraktuesi kryesor.
11. Këshilla të përgjithshme.
12. Puna ndërtimore në përgjithësi, ndërtimi dhe ndërtimi i skelave për punët rrugore përfshirë gërmimet, shkatërrimet, ndërtimin e rezervave të ujit, kanalizimeve dhe të ngjashme.
13. Tregtia, shitja, Import-eksporti i produkteve, materialeve të ndërtimit dhe makinerive të ndryshme thelbësore për ushtrimin e biznesit.
14. Ushtrimi i biznesit në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin.

 2

15. Çdo veprimtari tjetër në lidhje me veprimtarinë kryesore

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar.
Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise ,eshte ne adresen: Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit
"Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II
KAPITALI
NENI 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1000 (njemije) leke i perbere nga nje(1) kuote.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen 100% nga Ortaku i vetem :

- ***MARIO PANELLA, atesia (GIOVANNI), shtetas italian, lindur me 19/09/1964, ne (ROMA) , Itali dhe banues ne ROME , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AV 0039582***

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejta kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejta qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimie, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE NENI 8 ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Limerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe cksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi, i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.



NENI 9
THIRRJA E Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, orcn e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirruar sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperem nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij



- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposthem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- ***MARIO PANELLA, atesia (GIOVANNI), shtetas italian, lindur me 19/09/1964, ne (ROMA) , Itali dhe banues ne ROME , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AV 0039582***

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare.
- b) Perfaqesojne shoqerine.
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise.
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

 6

NENI 15
PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
2. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit

 7

- d. Nëse nuk zhvillon aktivitet tregëtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykatë.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregëtare.

NENI 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me ³/₄ e votave në sipas dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregëtare.

NENI 21
LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

NENI 22
MOSMARRVESHJET

Për mosmarrveshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretet, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italyane, me vlerë të njëjtte ligjore.

ORTAKU THEMELUES

MARIO PANELLA

